

Në bazë të nenit 24-a paragrafit 18 të Ligjit për Arsimin e Mesëm („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 dhe 64/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 229/20, 78/25, 132/25 dhe 250/25), ministrja e Arsimit dhe Shkencës përcaktoi

RREGULLORE

për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve shkollore të nxënësve të shkollave të mesme

Neni 1

Në Rregulloren për mënyrën e realizimit të ekskursioneve shkollore të nxënësve të shkollave të mesme me nr. 13-10833/1 të datës 04.08.2025, në nenin 13 pas paragrafit 6, shtohet paragraf i ri 7, i cili thotë:

"Në përjashtim nga paragrafi 6 i këtij neni, në rastin kur nxënësit dhe prindërit/kujdestarët e tyre kanë dhënë pëlqimin me shkrim për kohëzgjatje më të shkurtër të ekskursionit për shkak të arsyeve financiare ose arsyeve të tjera të justifikuara, numri i netëqëndrimeve mund të jetë më i vogël, por proporcional me numrin e ditëve të ekskursionit përfundimtar."

Paragrafët 7 dhe 8 bëhen paragrafë 8 dhe 9.

Neni 2

Në nenin 22, pas paragrafit 3 shtohen tre paragrafë të rinj 4, 5 dhe 6, të cilët thonë:

"Me përjashtim nga paragrafi 3 alineja 4 e këtij neni, nëse numri i nxënësve është më i vogël ose ekziston nevoja për transport shtesë, transporti mund të realizohet edhe me autobus të paraparë për transport deri në 50 persona ose me veturë pasagjerësh (8+1), të cilat i plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara konform dispozitave të Rregullores për kërkesat e veçanta teknike të automjeteve me të cilat transportohen grupe fëmijësh.

Transporti mund të organizohet edhe në mënyrë të kombinuar (autobus dhe/ose veturë pasagjerësh (8+1)).

Transporti i nxënësve në komunikacionin rrugor të brendshëm mund të realizohet me autobusë ose me vetura pasagjerësh (8+1), ndërsa transporti i nxënësve në komunikacionin rrugor ndërkombëtar mund të realizohet vetëm me autobusë (automjete me mbi 8+1 ulëse)."

Paragrafët 4 dhe 5 bëhen paragrafë 7 dhe 8.

Neni 3

Kjo rregullore hynë në fuqi ditën e nesërme nga dita e sjelljes së saj.

Nr. _____

Shkup

Ministria e Arsimit dhe Shkencës,
Проф. д-р Весна Јаневска

